



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



DEPARTAMENTI I GAZETARISË

PREZANTIMI I FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË MEDIA NË KOSOVË

Prishtinë, 2021

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të Komisionit të Pavarur të Mediave me Universitetin e Prishtinës, Departamentin e Gazetarisë, dhe Institutin e Mediave të Kosovës.

Përmbajtja

HYRJE	4
Metodologjia	5
Rezultatet e Monitorimit	6
Analiza Krahase – Gjendja e përgjithshme në media	11
Përfundimet	18

Tabela e Figurave

Figura 1 Sa shpesh brenda 30 ditëve, transmetohen përmbajtje lidhur me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve	11
Figura 2 Sa shpesh brenda 30 ditëve, transmetohen përmbajtje lidhur me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve- Rezultatet në minuta	12
Figura 3 Renditja e kronikave me pjesëmarrje të fëmijëve	12
Figura 4 Ndarja sipas temave e përmbajtjeve mediale që janë transmetuar lidhur me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve	13
Figura 5 Temat e trajtuara gjatë kronikave me pjesëmarrje të fëmijëve	14
Figura 6 Konteksti i paraqitjes	14
Figura 7 Si janë prezantuar fëmijët dhe të miturit në televizione	16
Figura 8 Zbulimi i identitetit të fëmijëve në edicionet e monitoruara	17
Figura 9 Përdorimi i deklaratave nga fëmijët në edicionet e monitoruara	17

HYRJE

Ky projekt përfshin monitorimin e mediave për të analizuar prezantimin e fëmijëve dhe të miturve në televizione. Analizimi është bërë nga data 16.09.2021 dhe deri më 15.10.2021, si mostër e rastësishme. Objekt i analizës kanë qenë emisionet e tetë mediave të ndryshme si: Televizioni Publik i Kosovës (RTK1), Kohavision (KTV), Radio Televizioni 21 (RTV21), Klan Kosova, Televizioni 7, Kanal 10, Radio Televizioni Dukagjini dhe Televizioni ATV.

Ky projekt është mbikëqyrur nga Departamenti i Gazetarisë, ndërsa në implementimin e tij ka dhënë

kontribut të rëndësishëm KPM-ja pasi që i gjithë procesi i monitorimit të mediave është kryer në zyrën e KPM-së nën asistencën e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës, si dhe është mbështetur nga IMK-ja.

Ky hulumtim është realizuar pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Departamentit të Gazetarisë dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM). Në hulumtim ishin të përfshirë katër studentë të Departamentit të Gazetarisë, Altiana Zogaj, Rreze Sylhasi, Shefket Bujari dhe Shpresë Hasimi.

Metodologjia

Ky projekt është realizuar përmes monitorimit të shërbimeve mediale audiovizuele të licencuara në KPM. Televizionet e përfshira në këtë hulumtim janë: Radio Televizioni i Kosovës (RTK1), Radio Televizioni 21, KTV, Radio Televizioni Dukagjini, Klan Kosova, Kanal 10 dhe ATV. Periudha e analizimit të këtyre emisioneve ka qenë data 16.09.2021. Emisionet e zgjedhura në këto televizione, kanë qenë emisionet e transmetuara në “Prime Time”, duke filluar nga ora 19:00 deri në orën 22:00.

Që analizimi i rezultateve të jetë sa më i saktë është përdorur programi statistikor (SPSS), në të cilin janë caktuar pyetjet e ndryshme që lidhen me temën bashkë me variablat me vlerat e dhëna për to.

Gjatë këtij hulumtimi është përdorur metoda kuantitative e analizimit të edicioneve informative në tetë televizione të ndryshme në Kosovë. Në hulumtim janë analizuar përgjigjet e trembëdhjetë pyetjeve të koduara, të cilat lidhen drejtpërdrejt me fokusin kryesor të temës së hulumtimit. Qëllimi i këtij projekti të monitorimit në 8 televizione ka të bëjë me hapësirën që u kushtojnë televizionet përmbajtjeve që lidhen me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve, temat në të cilat fëmijët prezantohen dhe si trajtohen fëmijët dhe të miturit në kronikat e lajmeve.

Rezultatet e Monitorimit

Rezultate e monitorimit në 8 televizione janë prezantuar më poshtë duke treguar mbi hapësirën që u kushtojnë televizionet përmbajtjeve që lidhen me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve, temat në të cilat fëmijët prezantohen dhe si trajtohen fëmijët dhe të miturit në kronikat e lajmeve.

Në **RTK1** gjatë 30 ditëve, vetëm në katër ditë ka pasur përmbajtje që lidhen me fëmijët dhe të miturit. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që në RTK1 gjatë 30 ditëve në prime time, në edicionin qendror të lajmeve nga ora 19:30 janë transmetuar në total vetëm 9 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Kronikat që janë transmetuar në RTK1 gjatë kësaj kohe të gjitha kanë temë arsimin. Por analizuar nga konteksti nuk lidhen me suksesin e fëmijës, as nuk prezantohet fëmija si viktimë apo kryes i veprave, as si rast social por në kontekste të tjera ku nuk është personazh kryesor i temës së trajtuar por si burim dytësor. Të katër kronikat janë përcjellë me pamje të fëmijëve apo të miturve, në dy prej tyre apo në total gjysmës së tyre janë përcjellë edhe të dhënat mbi identitetin e fëmijëve apo të miturve. Ndërsa, deklaratë nga ta është marrë vetëm në një rast. Të gjitha kronikat e transmetuara në RTK1 që lidhen në përmbajtje me prezantimin e fëmijëve apo të miturve janë renditur kah fundi i edicionit, konkretisht të gjitha kanë qenë të renditura si kronika e 9-të e më vonë.

Po ashtu edhe në **KTV** ngjashëm si në RTK1, përmbajtje që lidhen me fëmijët dhe të miturit ka pasur vetëm në 4 ditë. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që në KTV gjatë 30 ditëve në “prime time” në edicionin qendror të lajmeve nga ora 19:00 janë transmetuar në total 12 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Gjysma e këtyre kronikave kanë trajtuar tema nga fusha e arsimit dhe gjysma nga fusha e shëndetësisë. Në të gjitha kronikat fëmijët kanë qenë burime dytësore të transmetuara vetëm me pamje. Në të dy kronikat nga fusha e arsimit janë zbuluar edhe të dhënat që lidhen me identitetin e tyre, ndërsa në të dy rastet nga fusha e shëndetësisë nuk janë zbuluar të dhënat e identitetit të fëmijëve apo të miturve. Mirëpo, nëse analizojmë pamjet, atëherë del se pamjet e fëmijëve janë mbuluar vetëm në një rast. Ndërsa,

deklarata nga fëmijët apo të miturit janë marrë në të dy rastet e arsimit kur në të dy rastet e shëndetësisë nuk janë marrë deklarata nga ta. Të gjitha kronikat e transmetuara në KTV që lidhen në përmbajtje me prezantimin e fëmijëve apo të miturve janë renditur kah fundi i edicionit, konkretisht të gjitha kanë qenë të renditura si kronika e 7-të e transmetuar ose më vonë.

Në **RTV21** ka pasur përmbajtje që lidhen me fëmijët dhe të miturit në 11 ditë. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që në RTV21 gjatë 30 ditëve në “prime time” në edicionin e lajmeve janë transmetuar në total 30 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Nga 11 kronikat e transmetuara më së shumti ka pasur nga arsimi gjithsej 5, pastaj nga shëndetësia 3 kronika, nga fusha sociale kanë qenë dy kronika dhe një kronikë e transmetuar në kohë ka trajtuar tema të veprave kriminale. Nga të gjitha këto kronika fëmijët apo të miturit janë prezantuar kryesisht si burime dytësore vetëm me pamje, ndërsa në një rast fëmijët apo të miturit janë prezantuar si personazh suksesi dhe në një rast si viktimë. Vetëm në rastin kur fëmijët apo të miturit janë prezantuar si personazh suksesi janë zbuluar të dhëna që lidhen me identitetin e tyre, ndërsa në ta gjitha rastet tjera këto të dhëna nuk janë zbuluar. Mirëpo pamje të fëmijëve apo të miturve ka pasur në të gjitha kronikat e transmetuara në RTV21 gjatë kohës së monitorimit. Në 8 kronika nuk ka deklarata të fëmijëve apo të të miturve ndërsa në tri kronika janë marrë edhe deklarata nga fëmijët apo të miturit. Kryesisht të gjitha kronikat kanë qenë të renditura si kronika e 7-të ose më vonë. Vetëm në një rast kronika që lidhet me prezantimin e fëmijëve apo të miturve është transmetuar në mesin e 5 kronikave të para duke u transmetuar si kronika e 4-të. Kjo kronikë për temë ka pasur arsimin dhe nuk janë zbuluar të dhëna të fëmijëve apo të miturve por vetëm janë shfrytëzuar si burime dytësore të përcjella me pamje.

Në televizionin **Klan Kosova** gjatë 30 ditëve të monitorimit, përmbajtje që lidhen me fëmijët apo të miturit ka pasur në 17 ditë gjatë “prime time” në edicionin qendror të lajmeve nga ora 20:00. Ky televizion ka transmetuar përmbajtje që lidhen me fëmijët apo të miturit në më shumë kronika brenda ditës. Kështu del që gjatë 30 ditëve në Klan Kosova janë transmetuar 26 kronika që lidhen me fëmijët apo të miturit. Në maksimum 5 kronika që lidhen me prezantimin e fëmijëve apo të miturve janë transmetuar brenda ditës. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që në Klan Kosova gjatë 30 ditëve në “prime time” në edicionin qendror të lajmeve në Klan

Kosova janë transmetuar në total 69 minuta, apo konkretisht 1 orë e 9 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Temat ku janë prezantuar fëmijët apo të miturit ka dominuar fusha e politikës në 8 kronika, pastaj renditet më nga 5 kronika nga fusha e arsimit dhe veprave kriminale, ndërsa 4 kronika kanë temë sociale, 3 kronika nga ekonomia dhe një nga shëndetësia dhe një nga sporti. Kryesisht fëmijët apo të miturit në shumicën e storjeve janë trajtuar si burime dytësore dhe janë përcjell vetëm me pamje ndërsa në dy raste fëmijët apo të miturit prezantohen si viktima dhe në një rast konteksti i përdorimit të fëmijëve apo të miturve është kërkesë për ndihmë shëndetësore. Në shumicën e rasteve, pra në 21 kronika janë përdorur pamjet e fëmijëve dhe të miturve ndërsa në 4 raste nuk janë përdorur pamjet e fëmijëve dhe të miturve. Nga 26 storje në 3 storje janë publikuar të dhënat e fëmijëve apo të miturve, dy raste nga të cilat kanë pasur për temë veprat kriminale ku fëmijë apo të miturit janë prezantuar si viktima, ndërsa rasti tjetër ka qenë nga fusha e arsimit. Në shumicën e kronikave nuk janë transmetuar deklarata të fëmijëve pra në 22 raste, ndërsa në 4 kronika janë transmetuar edhe deklarata nga fëmijët apo të miturit. Nga këto 4 raste kur është transmetuar deklarata e fëmijëve apo të miturve, në dy raste tema është mbi arsimin, në një rast mbi ekonominë dhe në një rast për vepra kriminale. Katër kronika që lidhen me prezantimin e fëmijëve apo të miturve janë transmetuar si të parat dhe dy kronika janë transmetuar si e dyta edhe një është në top 5-shën duke u transmetuar si e katërta, ndërsa të tjerat si të 7-tat dhe më vonë. Në katër rastet kur kanë qenë kronika kryesore duke u renditur si e para, në 2 raste temë ka qenë arsimi, një temë ka pasur vepra kriminale dhe një nga fusha sociale. Nga këto raste vetëm në një rast transmetohet edhe deklarata nga fëmijët apo të miturit kur tema është për vepra kriminale. Por, fëmija apo i mituri trajtohet si burim dytësor.

Gjatë 30 ditëve në **T7** ka pasur përmbajtje që lidhen me fëmijët dhe të miturit vetëm në dy ditë. Ky televizion ka transmetuar përmbajtje që lidhen me fëmijët apo të miturit në më shumë kronika brenda ditës. Kështu del që gjatë 30 ditëve në T7 janë transmetuar 4 kronika që lidhen me fëmijët apo të miturit. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që vetëm në 6 minuta gjatë 30 ditëve në “prime time” në edicionin qendror të lajmeve nga ora 19:30 janë transmetuar në total vetëm 9 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Kronikat që janë transmetuar në T7 gjatë kësaj kohë të gjitha kanë temë arsimin. Por analizuar nga konteksti fëmijët trajtohen si burim dytësor. Të katër kronikat janë përcjellë me pamje të fëmijëve apo të miturve, në dy prej

tyre apo në total gjysmës së tyre janë përcjellë edhe të dhënat mbi identitetin e fëmijëve apo të miturve. Edhe deklaratat nga ta janë transmetuar në të gjitha rastet. Gjysma e kronikave që lidhen me fëmijët apo të miturit janë renditur si kronika e 5-të në edicionin informativ në T7 dhe gjysma tjetër e kronikave janë transmetuar si storje si të 10-tat me radhë.

Në **Televizionin Dukagjini** gjatë 30 ditëve të monitorimit vetëm në dy ditë në “prime time” janë transmetuar kronika që lidhen me fëmijët apo të miturit. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që në TV Dukagjini gjatë 30 ditëve në “prime time” në edicionin qendror të lajmeve nga ora 19:00 janë transmetuar në total vetëm 4 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Kronikat që janë transmetuar në TV Dukagjini njëra është nga fusha e shëndetësisë dhe njëra nga fusha e politikës. Në këto kronika fëmijët apo të miturit trajtohen si burim dytësor dhe përcillen vetëm me pamje. Të dhënat e fëmijëve nuk përmenden në asnjërin rast, megjithëkëtë në njërin rast publikohen pamje të fëmijës. Dhe po ashtu, në asnjërin rast nuk transmetohen deklaratat nga fëmijët apo të miturit. Njëra kronikë transmetohet si e katërta në renditje të edicionit qendror ndërsa tjetra renditet e dhjeta.

Gjatë 30 ditëve në **Kanal 10** ka pasur përmbajtje që lidhen me fëmijët dhe të miturit në 13 ditë. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që në Kanal 10 gjatë 30 ditëve në “prime time” në edicionin qendror të lajmeve nga ora 19:00 janë transmetuar në total vetëm 28 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Temat ku janë prezantuar fëmijët apo të miturit ka dominuar fusha e politikës në 7 kronika, pastaj renditen 4 kronika nga fusha e arsimit, dhe nga një të fushës së ekonomisë dhe një në lidhje me veprat kriminale. Kryesisht fëmijët dhe të miturit në këto kronika janë trajtuar si burime dytësore me pamje. Vetëm një kronikë bën përjashtim ku fëmijët apo të miturit trajtohen në kontekste të viktimës dhe në atë rast janë zbuluar edhe të dhënat e fëmijës apo të miturit por nuk është zbuluar pamja dhe as nuk është transmetuar deklarata nga ta. Në rastet e tjera të dhënat e fëmijës apo të miturit kryesisht nuk janë zbuluar, përjashtim bën vetëm në një kronikë e cila flet për arsimin. Në kronikat e Kanal 10 pamjet e fëmijëve janë prezantuar në pothuajse të gjitha rastet, përjashtim bën vetëm rasti i cekur më lart që trajton fëmijën apo të miturin si viktimë. Nga 13 kronika deklarata nga fëmijët apo të miturit janë transmetuar vetëm në dy raste, në të dy rastet kur temë ka qenë arsimi. Kronika që ka trajtuar fëmijën apo të

miturin si viktimë në temën për vepra kriminale është kronika që u rëndit si e dyta në edicionin informativ të Kanal 10. Kronikat e tjera në dy raste që lidhen më fëmijët dhe të miturit renditen si e 5-ta ndërsa tjerat renditen më vonë.

Në televizionin **ATV** gjatë 30 ditëve monitorim, ky televizion në 12 ditë ka transmetuar në “prime time” në edicionin e lajmeve nga ora 19:00 përmbajtje që lidhen më fëmijët apo të miturit. Gjithsej ka transmetuar 13 kronika meqë në një ditë transmeton dy kronika që lidhen më prezantimin e fëmijëve apo të miturve. Analizuar nga kohëzgjatja e kronikave i bie që në ATV gjatë 30 ditëve në “prime time” në edicionin qendror të lajmeve nga ora 19:30 janë transmetuar në total 29 minuta që lidhen me përmbajtjet me fëmijë dhe të mitur. Temat e kronikave që lidhen me fëmijët dhe të miturit kryesisht kanë qenë nga fusha e arsimit gjithsej 8 kronika, ndërsa nga 2 kanë qenë të fushës së sociale dhe dy të veprave kriminale, dhe një kronikë ka qenë e fushës së shëndetësisë e cila është lidhur me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve. Në 10 kronika fëmijët apo të miturit kanë qenë burime dytësore dhe janë përdorur vetëm si pamje, ndërsa në 3 kronika fëmijët apo të miturit janë prezantuar në kontekst të viktimës. Dy prej këtyre rasteve kanë pasur për temë veprat kriminale dhe një ka qenë temë sociale. Në dy rastet kur fëmijët apo të miturit prezantohen si viktimë në temën për vepra kriminale, në njërin rast publikohen të dhënat dhe pamja e fëmijës por nuk merret deklarata nga ai/ajo, ndërsa në rastin tjetër kur trajtohet si viktimë nuk publikohen të dhënat e fëmijës apo të miturit e as pamja e tyre dhe as nuk transmetohen deklarata nga ta. Ndërsa në rastin kur fëmijët prezantohet si viktimë në temën sociale, të dhënat e identitetit të fëmijës apo të miturit zbulohen por nuk transmetohen pamjet e tyre dhe as deklarata nga ta. Në rastet e tjera për temat e tjera, pra analizuar nga të gjitha kronikat e monitoruara në këtë televizion nga 13 kronika, në 6 kronika zbulohen të dhënat e fëmijës apo të miturit. Pastaj nga 13 kronikat në 4 kronika prezantohen pamjet e fëmijëve dhe të miturve ndërsa deklarata nga ta transmetohen vetëm në 2 kronika. Analizuar nga renditja kryesisht kronikat ku prezantohen fëmijët apo të miturit nuk janë në mesin e kronikave të para dhe ato transmetohen nga kronika e shtatë e më vonë.

Analiza Krahasese – Gjendja e përgjithshme në media

Brenda 30 ditëve, në edicionet informative në televizionet në Kosovë mesatarisht në 8 ditë ka pasur kronika që lidhen me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve, apo shikuar nga numri i kronikave, mesatarja nga të gjitha televizionet në Kosovë është 11 kronika brenda 30 ditëve. Fëmijët dhe të miturit janë prezantuar në kohën e “prime time” (pikut) në edicionin informativ më së shpeshti në Klan Kosova. Ndërsa më së rralli ka pasur kronika të tilla në edicionet informative të Televizionit Dukagjini. Televizionet Klan Kosova, ATV dhe T7 ka pasur raste kur brenda ditës kanë transmetuar më shumë se një kronikë. Ndërsa, RTK1, KTV dhe Kanal10 brenda 30 ditësh asnjëherë nuk kanë transmetuar më shumë se një kronikë gjatë ditës me përmbajtje që lidhen me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve.




Figura 1 Sa shpesh brenda 30 ditëve, transmetohen përmbajtje lidhur me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve

Analizuar nga hapësira totale varësisht nga gjatësia e kronikave, del që mesatarja që televizionet në Kosovë i kanë kushtuar prezantimit të fëmijëve është 23 minuta brenda 30 ditëve. Mbi një orë brenda 30 ditëve ka vetëm Klan Kosova, ndërsa 4 minuta brenda 30 ditësh ka TV Dukagjini.

HAPËSIRA TOTALE NË MINUTA

RTK	9
KTV	12
RTV21	30
KLNA KOSOVA	69
T7	6
TV DUKAGJINI	4
KANAL 10	28
ATV	29

Figura 2 Sa shpesh brenda 30 ditëve, transmetohen përmbajtje lidhur me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve- Rezultatet në minuta

Kryesisht të gjitha kronikat që kanë prezantuar fëmijët apo të miturit janë prezantuar kah fundi i edicionit informativ.

Renditja e kronikave me pjesëmarrje të fëmijëve në edicionet e monitoruara




Figura 3 Renditja e kronikave me pjesëmarrje të fëmijëve

Nga fusha e arsimit kanë dominuar kronika në të cilën janë prezantuar fëmijët dhe të miturit, gjithsej 42 për qind e kronikave në televizionet kosovare kanë qenë me tema nga arsimi. Pastaj 23 për qind e temave të kronikave të cilat lidhen me prezantimin e fëmijëve janë nga politika. Ndërsa 11 për qind e totalit të kronikave të prezantuara në TV kosovare janë tema që lidhen me vepra kriminale e në të cilat trajtohen fëmijët, 9 për qind janë sociale dhe shëndetësi, 5 për qind tema nga ekonomia. Ndërsa, më së paku fëmijët dhe të miturit janë prezantuar në kronikat me tema mbi sportin.



Figura 4 Ndarja sipas temave e përmbajtjeve mediale që janë transmetuar lidhur me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve

Televizionet RTK1 dhe T7 kanë transmetuar fëmijët dhe të miturit vetëm në tema që lidhen me arsimin. Por, si temë dominuese në raport me temat tjera që lidhen me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve, tema e arsimit ka qenë dominuese edhe në KTV, RTV21 dhe ATV. Ndërsa për politikën rreth gjysma e kronikave që kanë transmetuar lidhur me fëmijët dhe të miturit në Televizionin Dukagjini dhe Kanalin10 janë tema në fushën politike. Fëmijët dhe të miturit janë prezantuar në tema politike edhe në televizionin Klan Kosova më shumë në krahasim me temat e tjera të lidhura me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve.




Figura 5 Temat e trajtuara gjatë kronikave me pjesëmarrje të fëmijëve

Fëmijët dhe të miturit janë prezantuar edhe në tema për vepra kriminale. Në katër televizionet: Klan Kosova, ATV, RTV21 dhe Kanal10 janë prezantuar fëmijët në lidhje me prezantimin e fëmijëve dhe të miturve.

Fëmijët dhe të miturit në 89 për qind janë trajtuar si burime dytësore. Në një për qind janë prezantuar si personazh sukseesi, në të njëjtën përqindje janë prezantuar edhe në kontekst të ndihmës shëndetësore. Në 9 për qind fëmijët dhe të miturit janë portretizuar si viktime.




Figura 6 Konteksti i paraqitjes

Në kontekst të viktimave fëmijët dhe të miturit janë prezantuar në ATV në 3 raste, në Klan Kosova në 2 kronika dhe në një kronikë në Kanal10 dhe RTV21. Në ATV dy prej këtyre rasteve kanë pasur për temë veprat kriminale dhe një ka qenë temë sociale. Në dy rastet kur fëmijët apo të miturit prezantohen si viktimë në temën për vepra kriminale, në njërin rast publikohen të dhënat dhe pamja e fëmijës por nuk merret deklarata nga ai/ajo, ndërsa në rastin tjetër kur trajtohet si viktimë nuk publikohen të dhënat e fëmijës apo të miturit e as pamja e tyre dhe as nuk transmetohen deklarata nga ta. Ndërsa në rastin kur fëmijët prezantohet si viktimë në temën sociale, të dhënat e identitetit të fëmijës apo të miturit zbulohen por nuk transmetohen pamjet e tyre dhe as deklarata nga ta. Në Klan Kosova dy raste kur fëmijët apo të miturit janë portretizuar si viktima kanë qenë për temë veprat kriminale. Në të dy rastet janë zbuluar të dhënat për identitetin e tyre. Por nuk janë zbuluar pamjet e tyre e as nuk janë marrë deklarata nga ta. Edhe në Kanal10 janë zbuluar të dhëna mbi identitetin e tyre por nuk janë zbuluar pamje dhe as nuk janë transmetuar deklarata nga ta. Ndërsa, në RTV21 nuk janë publikuar të dhëna mbi identitetin e viktimës dhe as deklarata por pamje po.

Fëmijët dhe të miturit janë bërë pjesë e kronikave përmes pamjeve dhe mesatarja e kronikave që kanë transmetuar pamje të fëmijëve dhe të miturve është 7.5. Ndërsa, të dhënat mbi identitetin e fëmijëve dhe të miturve janë publikuar në mesatare prej 2 rasteve. Po ashtu, edhe deklarata nga fëmijët janë transmetuar në një mesatare 2 raste.




Figura 7 Si janë prezantuar fëmijët dhe të miturit në televizione

Duke u bazuar në tabelën e radhës mund të konstatohet se në shumicën e televizioneve të monitoruara ka pasur kronika që është zbuluar identiteti i fëmijëve. Identitetin e fëmijëve nuk e ka zbuluar vetëm njëri nga televizionet e monitoruar, pra Televizioni Dukagjini.




Figura 8 Zbulimi i identitetit të fëmijëve në edicionet e monitoruara

Ndërkaq, sa i përketë deklaratave të fëmijëve gjatë kronikave në edicionet informative, rezulton se në shumicën nga to nuk ka pasur fare deklarata të fëmijëve, por, vetëm janë përdorur pamje. Megjithatë, në një numër të kronikave edhe fëmijët kanë qenë protagonistë të storjeve.




Figura 9 Përdorimi i deklaratave nga fëmijët në edicionet e monitoruara

Përfundimet

- Shumica e televizioneve nuk ofrojnë përmbajtje të mjaftueshme të prezantimit të fëmijëve dhe të miturve në skemën e tyre të edicioneve informative;
- Televizioni Publik i Kosovës (RTK1) ofron hapësirë jashtëzakonisht të kufizuar temave që trajtojnë problemet e fëmijëve dhe të miturve;
- Kronikat në të cilat diskutohen problemet e fëmijëve zakonisht renditen në fund të edicioneve, që nënkupton kanë relevancë më të vogël të trajtimit;
- Kronikat e fushës së arsimit janë ato që i dominojnë kronikat për fëmijë, por mbetet i lartë përdorimi i fëmijëve në kontekstin politik;
- Në shumicën e kronikave televizive shfaqen pamjet e fëmijëve;
- Në një pjesë të madhe të kronikave televizive shfaqet identiteti i fëmijëve;
- Në shumicën e kronikave të monitoruara nuk ka pasur deklarata të fëmijëve.